



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERZORE DHE KOMUNIKIMIT ME PUBLIKUN
DREJTORIA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë, - Tel: 2 270 630, Fax: 2 270 627 - www.moe.gov.al

Nr. 4381 Prot.

Tirane, më 25. 07. 2011

U R D H Ë R

Nr 469 Datë 25.07.2011

“PËR

KRIJIMIN E STRUKTURËS SË SHËRMBIMIT TË EKSTENSIONIT TË PYJEVE”.

Në mbështetje të pikes 4 të nenit 102 të Kushtetutes, të nenit 7 të Ligjit 9385 datë 4.5.2010 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, te Vendimit te Keshillit te Ministrave me numer 26 date 13.01.2010 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në Ministrinë dhe Institucionet Qendrore“, të Urdhërit të Kryeministrit me numër 26 datë 24.02.2011 “Për miratimin e Strukturës dhe organikës së Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” ,

U R D H Ë R O J :

1. Në strukturën organizative aktuale të drejtorive të shërbimit pyjor krijohet Seksioni i Shërbimit të Ekstensionit dhe Pyjeve Komunal, me përbërje dhe numër sipas listës bashkëlidhur.
2. Propozimet për emrat e punonjësve, pjesë të kësaj strukture bëhen nga ana e drejtorve të shërbimit pyjor në rrethe, mbështetur në listën e punonjësve të përzgjedhur mbi bazën e kritereve të vendosura më parë dhe të trajnuar për këtë funksion.

3. Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave ne Ministri, brenda datës 25.07.2011 përcakton modalitetet për misionin, funksionin, detyrat dhe performancën e strukturës së shërbimit të ekstensionit dhe pyjeve komunal, në nivel lokal. Ky akt miratohet nga Ministri
4. Drejtoritë e shërbimit pyjor në rrethe pas ndryshimeve të bëra, me mbështetje të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministri, rikonfigurojnë strukturën organizative brenda datës 30.07.2011.
5. Struktura e ndryshuar nuk shoqërohet me ndryshim të numrit të punonjësve dhe as me efekte financiare të parshikuara për vitin 2011.
6. Për zbatimin e këtijë urdhëri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetese si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore nëpërmjet Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave si dhe Drejtorët e Shërbimit Pyjor në rrethe.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

FATMIR MEDIU